




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TEPELENË  
KËSHILLI BASHKIAK



Nr. 787/2 prot.

Tepelenë, më 04.05.2026

## V E N D I M

Nr. 32, datë 29.04.2026

**“Për miratimin në parim të zhvillimit të agroturizmit në sistemet bujqësore dhe natyrore sipas shprehjeve të interesit në tokat e dhëna me qira nga Bashkia Tepelenë”.**

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen Vendore” të ndryshuar; nenit 8 “Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor”; Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit”, të ndryshuar; Akteve ligjore dhe nënligjore në zbatim të tyre; ligjin nr.57/2020 “Për pyjet”; ligjit Nr.9693, datë 19.03.2007 “Për Fondin Kullor” i ndryshuar; Nenit 801 në vijim të ligjit Nr.7850. date 29.07.1994, “Per Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimin Nr. 559, datë 29.07.2022 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve”; VKM Nr.467, datë 31.7.2025 “ Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje ose kositje, për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme”; Udhezimit të Ministrit të Mjedisit nr.1 date 9.6.2016 “Per rregullat e procedurat e kërkimit, shqyrtimit e te miratimit te kërkesave per dhënien ne përdorim te fondit pyjor e kullor publik”, si dhe VKM-se Nr. 433 date 08.06.2016 “Per Transferimin ne Pronesi te Bashkive të Pyjeve dhe të kullotave Publike” te ndryshuar; VKB nr.38 datë 29.03.2023 “Për shprehjen e pëlqimit në parim për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullor ndodhur në Bashkinë Tepelenë”; ligjit nr.8312 date 26.3.1998 “Per tokat bujqesore te pandara”; VKM 531 date 21.8.1998 “Per tokat bujqesore te pandara” te ndryshuar; dhe ligjit nr.9244 date 17.6.2004 “Per mbrojtjen e tokes bujqesore” të ndryshuar; Udhezimit nr.1 date 18.07.2012 “Per procedurat e dhenies me qira te tokave bujqesore”; VKB nr.39 date 29.03.2023 “Per miratimin e listes me siperfaqet e tokave bujqesore per tu dhene me qira nga Bashkia Tepelenë”; Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit nr.52 datë 24.12.2024 “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Tepelenë”; Vendimit të Këshillit Bashkiak Tepelenë nr.60 datë 31.10.2024 “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tepelenë”; Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit nr.12 datë 27.02.2019 “Për miratimin e lejeve të ndërtimit/zhvillimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në njësitë që i përkasin sistemeve urban (UB), bujqësor (B) dhe natyror (N):

**VENDOSI:**

1. Miratimin në parim të zhvillimit në sistemet bujqësore dhe natyrore sipas shprehjeve të interesit në tokat e dhëna me qira nga Bashkia Tepelenë dhe lejimin e dhënies së lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në përputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor (PPV) të Bashkisë Tepelenë për:
- Objekte për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, sipas legjislacionit të posaçëm sektorial;
  - Struktura ku ushtrohet veprimtaria e agroturizimit, sipas përkufizimeve të legjislacionit të posaçëm sektorial.
2. Për zbatimin e këtij vendimi dhe ndjekjen e korrespondencës ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (DPKZHT) dhe Drejtoria e Zhvillimit Rural (DZHR).
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 për "Vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak  
Valbona ÇELA

Miratuar me 11 (njëmbëdhjetë) vota  
Vota Pro 11 (njëmbëdhjetë) vota  
Vota Kundër 0  
Vota Abstenim 0  
Zbardhur më datë 04.05.2026

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK  
ARBEN GUMENI**

